

KËRKIME GJUHËSORE

Rezana VRAPI

INTEGRIMI NË GJUHË

Fëmijët dhe të rriturit e zhvillojnë aftësinë për të shkruar, lexuar, folur, dëgjuar dhe menduar përmes përvojave që ata kanë në jetën e përditshme me të shkruarin, të lexuarin, të folurin, të dëgjuarin dhe të menduarin.

Integrimi në gjuhë nënkupton krijimin e situatave të përshtatshme të të nxëniet, në të cilat, të shkruarit, të lexuarit, të folurit dhe të dëgjuarit, mund të zhvillohen së bashku për qëllime dhe audiencë të vërtetë.

Ai mund të realizohet në tri mënyra të ndryshme. Më e përhapura është ajo ku, secila nga kompetencat e gjuhës mësohet së bashku me një tjetër. Të lexuarit mësohet përmes veprimtarive të përshtatshme me gojë dhe me shkrim; të shkruarit mësohet duke u përfshirë në lexim ashtu si do të përfshihej një shkrimtar: duke u shprehur me gojë, duke i lexuar miqve atë që ka shkruar dhe duke u përfshirë në veprimtari të ngjashme; gjuha e folur mësohet në kontekstin e mundësive të ndryshme për perceptimin dhe zhvillimin e gjuhës së shkruar.

Koncepti i dytë i integrimit përfshihet në të parin: çdo gjuhë është në vetvete një tërësi e integruar. Ajo nuk përbëhet nga pjesë të izoluara dhe të parëndësishme.

Së fundmi, integrimi mund të përfshijë zhvillimin e gjuhës në njëjtën kohë që zotërohen edhe fusha të tjera, të tilla si: shkencat shoqërore, matematika ose shkencat e natyrës, ashtu si në modelin e një “kurrikule kros kurrikulare”.

SI MUND TË REALIZOHET INTEGRIMI NË GJUHË?

Marrja e informacionit rreth disa aspekteve të gjuhës nuk është e njëjtë me zhvillimin e aftësive gjuhësore apo të ushtruarit për të lexuar, shkruar, dëgjuar dhe folur në një situatë reale komunikimi. Një mënyrë e mirë për të realizuar integrimin në gjuhë është të fokusohemi në diçka tjetër. Nëse qëllimi është të analizohet një fragment letrar, atëherë mësuesi duhet të zhvillojë mënyra të ndryshme të përvetësimit të atij fragmenti përmes të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit. Për shembull: komedia “14 vjeç dhëndër” e Çajupit mund të analizohet përmes një drame, ku përfshihet loja në role, pantonima dhe hartimi i një letre motivuese.

Kur fokusohemi në diçka tjetër, të ndryshme nga gjuha, mësuesi duhet të sigurojë mjedisin e duhur për të realizuar lidhjet me gjuhën. Për shembull, në sistemin parashkollor, një edukatore duhet të krijojë mundësitë që çdo figurë apo pikturë që fëmijët shikojnë të ketë të shkruar edhe emërtimin poshtë.

Kur ushtrohem për të përmirësuar të lexuarin, kjo duhet të përfshijë edhe përmirësimin e të shkruarit, sepse ne të gjithë i përdorim në mënyrë të pandashme dhe të qëllimshme të dyja. Ditarët, leximi i gazetave, shënimet mbi vëzhgime të ndryshme, të gjitha këto i përgatisin fëmijët për të hartuar raporte që lidhen me shkencat. Ndërsa, kur ata shkruajnë histori të vërteta apo trillime, duke përdorur si stimulues gjithçka që ndodh brenda ose jashtë shkollës, kjo i ndihmon në mënyrë të pashmangshme në zhvillimin e gjuhës.

Gjithashtu, integrimi në gjuhë promovohet edhe kur nxënësit hartojnë lista me pyetje, një skicë eseje, diskutojnë domethënien e historive apo poezive, vendosin se si të hartojnë një raport në grup, redaktojnë punën e njëri-tjetrit përpara publikimit, planifikojnë një dramë për në teatër apo mënyra të tjera të ritregimit.

Mjedisi shkollor për mësimin e integruar duhet të jetë i strukturuar, me mundësi të shumta për të shkruar dhe lexuar për periudha të gjata dhe krijimin e hapësirave për të diskutuar në lidhje me tema dhe çështje të caktuara. Mësuesit duhet të shërbejnë si një model duke i tërhequr në veprimtari të tilla. Nxënësit mund të përftojnë nënaftësi përmes ndërveprimeve me të tjerët dhe me materiale të shkruara. Kështu, i ata do ta kuptonin gjuhën përmes proceseve të integruara si një e tërë dhe jo të fragmentuara.

PSE INTEGRIM?

Integrimi në gjuhë sjell shumë përparësi. Së pari, fëmijët i mësojnë të gjitha aspektet e gjuhës duke e përdorur këtë të fundit në situata të qëllimshme. Ne, të rriturit, i përdorim në mënyrë shumë të natyrshme aspektet e gjuhës. Duke integruar gjuhën në mësimdhënie, ne i vendosim fëmijët në situata të cilat duhet të përpunohen me mënyrën me të cilën ata natyrshëm do ta mësojnë dhe përdorin atë. Së dyti, duke integruar gjuhën, fëmijët dhe të rinjtë zhvillojnë më mirë aftësitë e tyre të të menduarit kritik. Kjo është veçanërisht e vërtetë kur të shkruarit dhe të lexuarit mësohen bashkë.

GJUHA E FOLUR: TË FOLURIT DHE TË DËGJUARIT

Të folurit dhe të dëgjuarit janë aspekte të gjuhës së folur. Për shumë vite, kërkimet kanë treguar se ka një lidhje të fortë midis gjuhës së folur dhe të lexuarit, të shkruarit dhe të menduarit. (Loban, 1963; Menyuk, 1984). Gjuha e folur është baza mbi të cilën zhvillohen të gjitha aspektet e tjera të gjuhës. Për këtë arsye, është shumë e rëndësishme që nxënësit të mbështeten vazhdimisht në zhvillimin e gjuhës së folur përgjatë të gjitha viteve të shkollimit. Fëmijët dhe të rriturit e zhvillojnë gjuhën e folur duke e përdorur atë. Ka arsye të besojmë se nxënësit i fitojnë aftësitë në shkrim në të njëjtën mënyrë.

TË SHKRUARIT

Të mësuarit për të shkruar është një pjesë e rëndësishme e zotërimit të gjuhës. Studimet kanë treguar se fëmijët mësojnë të shkruajnë duke shkruar. (Graves, 1975, 1983).

Shumë fëmijë fillojnë të "shkruajnë" duke vizatuar dhe shkarravitur në mënyrë spontane; me fitimin e përvojës, shkrimi i tyre merr formë më të rregullta. Ky zhvillim mund të përforcohet përmes përdorimit të proceseve më fleksibël që përfaqësojnë: përzgjedhjen e një teme, skicimin, rishikimin, redaktimin dhe publikimin (Hillocks, 1984, 1987).

Përmes këtij procesi fëmijët mësojnë të përdorin gramatikën dhe elementet e gjuhës. Ky proces i të shkruarit u jep nxënësve një kornizë për përvoja të tjera shumë më të larmishme e të qëllimshme të të shkruarit. Pikërisht, përmes procesit të rishikimit, nxënësit përmirësojnë të shkruarin dhe mësojnë më mirë rregullat e drejtshkrimit. Megjithatë, rishikimi nuk është një proces i natyrshëm

INTEGRIMI NË GJUHË

për fëmijët; ata duhet të mbështeten për ta realizuar atë. Gjithashtu, fëmijët kanë nevojë për përvoja të ndryshme me të shkruarin; për ta zotëruar sa më mirë atë, ata duhet të shkruajnë të paktën katër herë në javë. (Graves, 1991).

NDIKIMI I LETËRSISË NË TË SHKRUAR

Në programin e gjuhës shqipe, nxënësit kanë shumë shanse të lexojnë dhe dëgjojnë vepra letrare shumë cilësore. Këto përvoja që ata përftojnë, ndikojnë në mënyrën se si ata shkruajnë. Për shembull: nëse nxënësit dëgjojnë ose lexojnë përshkrime shumë të arrira dhe bëhen të ndërgjegjshëm në lidhje me përshkrimet përmes diskutimeve dhe veprimtarive të tjera, ata fillojnë të përfshijnë tipa të ngjashëm të përshkrimeve në shkrimet e tyre.

Temat mësimore që përqendrohen në gjini të ndryshme letrare (histori, tekste informative, etj) mund të shërbejnë si modele për t'i udhëzuar nxënësit në disa tipa të të shkruarit (histori, raporte, informacione etj).

DREJTSHKRIMI

Të nxënit për t'i shkruar drejt fjalët është pjesë e zotërimit të gjuhës. Ai përfshin shumë më tepër se sa mësimi përmendësh i disa fjalëve. Fëmijët mësojnë t'i drejtshkruajnë fjalët drejt duke pasur përvoja të vërteta, ku përfshihet drejtshkrimi. Sa më shumë përvoja të tilla të kenë pasur, aq më mirë ata janë në gjendje të njohin dhe përdorin modele të drejtshkrimit, që do t'i ndihmonin të shkruanin si duhet fjalët.

Studimet tregojnë se fëmijët mësojnë të drejtshkruajnë në mënyra nga më të ndryshmet: duke pasur përvoja me të lexuarin, të cilat u japin atyre modele se si duhen shkruar fjalët; duke shkruar dhe korrigjuar, duke përzgjedhur fjalë për t'i studiuar vetë dhe duke marrë mësim, kur është e nevojshme, për t'u përqendruar në fjalë të veçanta, në një rregull apo modele të drejtshkrimit, që mund t'i kenë shkaktuar vështirësi në të shkruar. Në qendër të të gjitha këtyre veprimtarive janë mundësitë për të shkruar.

TË SHKRUARIT DHE KORREKTIMI

Të shkruarit dhe korrektimi janë shumë të rëndësishëm që fëmijët të mësojnë të shkruajnë si duhet fjalët. Fëmijët fillojnë dhe bëhen të ndërgjegjshëm në lidhje me modelet e ndryshme të drejtshkrimit nëse ata kanë mundësi të qëllimshme dhe reale për të shkruar. Nga shkrimet e ndryshme që ata realizojnë, fëmijët mund të përzgjedhin vetë disa fjalë dhe t'i studiojnë.

GRAMATIKA DHE PËRDORIMI

Pse u mësojmë fëmijëve gramatikën dhe përdorimin e saj? Mendohet se qëllimi primar është përmirësimi i mënyrës së tyre të të shkruarit. Në këtë pikë ka një shumëllojshmëri studimesh, të shtrira ndër vite (Hillocks & Smith, 1991). Përfundimi i përgjithshëm i tyre është se studimi i gramatikës nuk ka ndonjë ndikim në cilësinë e të shkruarit (Hillocks & Smith, 1991). Ajo çfarë fëmijët dhe të rriturit duhet të dinë rreth gramatikës dhe përdorimit të saj e mësojnë shumë më mirë përmes të shkruarit. (Hillocks, 1984, 1987). Nëse nxënësit kanë vështirësi me një element të veçantë të gramatikës apo përdorimit të saj në të shkruar, mësuesi mund t'u japë një mësim të shkurtër, i cili përqendrohet pikërisht në atë element,

duke përdorur një shkrim të bërë nga vetë nxënësit ose një pjesë letrare si model për atë rast.

Lidhja midis të shkruarit dhe të lexuarit: mendimi kritik

Të lexuarit dhe të shkruarit janë procese të ngjashme. Ato janë të dyja konstruktive. Kur individët lexojnë atë kalojnë përmes një procesi, i cili është i ngjashëm me të shkruarit. Rezultati i të shkruarit dhe të lexuarit është se individë e krijojnë vetë të kuptuarin. Ndaj është mjaft e qartë se të dy proceset duhen mësuar së bashku. Megjithatë të lexuarit dhe të shkruarit nuk janë procese identike, ka shumë arsye për t'i mësuar ato së bashku. Studimet kanë treguar se kur ato mësohen kështu, nxënësit arrijnë rezultate më të mira në të dyja fushat (Tierney & Shanahan, 1991). Një nga përfitimet më domethënëse është se nxënësit fillojnë të mendojnë në mënyrë kritike shumë më mirë. Tipat e veprimtarive që lidhin të lexuarit me të shkruarin dhe që përmirësojnë të menduarin kritik, janë pikërisht ato që nxisin një interpretim personal në letërsi (Tierney & Shanahan, 1991).

BIBLIOGRAFI

- Calkins, Lucy McCormick. LESSONS FROM A CHILD: ON THE TEACHING AND LEARNING OF WRITING. Exeter, NH: Heinemann, 1983.
- Ferreiro, Emilia, and Ana Teberosky. LITERACY BEFORE SCHOOLING. Exeter, NH: Heinemann, 1982.
- Goodman, Kenneth. "Reading as a Psycholinguistic Guessing Game." JOURNAL OF READING SPECIALIST 6 (1967): 126-35.
- Graves, Donald H. WRITING: TEACHERS AND CHILDREN AT WORK. Exeter, NH: Heinemann, 1983.
- King, Martha L., and Victor Rentel. HOW CHILDREN LEARN TO WRITE: A LONGITUDINAL STUDY. Final Report to the National Institute of Education 1981. ED 213 050.
- Read, Charles. "Pre-School Children's Knowledge of English Phonology." HARVARD EDUCATION REVIEW 41 (1971): 1-34.
- Scollon, Ron, and B. K. Suzanne Scollon. "The Literate Two-Year-Old: The Fictionalization of the Self." In NARRATIVE, LITERACY AND RACE IN INTERETHNIC COMMUNICATION. Norwood, NJ: Ablex, 1981.
- Smith, Frank. ESSAYS INTO LITERACY. Exeter, NH: Heinemann, 1983.